



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.322/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur lidhur me ankesën e Organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shpërndarjes së materialeve zgjedhore në vend votime, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e Organizatës BIRN dhe IKS, Anr.322/2019 e datës 06.10.2019, me të cilin ka kërkuar që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) t'i shqiptohet gjobë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes - shpërndarjes së materialeve zgjedhore në vend votime në ditën e votimit.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Organizata BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, me datën 06.10.2019, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 06.10.2019, ne ora 10:00, në afërsi të Qendrës së Vendvotimit, në afërsi të shkollës fillore “Emin Duraku”, në Prishtinë, shihen disa kartëvizita me nr. 88, të kandidatit për deputet nga subjekti politik LDK.

Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me Ligjin e Zgjedhjeve, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes së partive politike të cilat qartazi parashohin se 24 orë para zgjedhjeve, të gjitha materialet/posteret propagandistike duhet të hiqen në rast se ndodhen në afërsi prej 100 metrave nga ndonjë Qendër e Vendvotimit.

Në përgjigjën në ankesë, të datës 07.10.2019, subjekti politik LDK, thekson se ankesa është e pabazuar, ngase siç shihet edhe në fotografit e printuara, bëhet fjalë për të njëjtën kartëvizitë por e fotografuar në dy pozicione të ndryshme, e që mund të jetë hedhur nga ndonjë qytetar ditë më parë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografit, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se në bazë të fotografive të prezantuar si provë materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet me nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, ashtu që në afërsi të Qendrës së Votimit në një distancë më të afërt se 100 metra është bërë shpërndarja e materialit zgjedhor nga aktivist të këtij subjekti.

Në fotografi shihen kartëvizitat e vendosura në dy pozicione të ndryshme, ndërsa qendra e votimit nuk shihet, nuk ka mundësi nga një fotografi e tillë të identifikohet qendra e votimit dhe si rrjedhojë në pamundësi të identifikimit të qendrës së votimit, është e pamundur të përcaktohet distanca e kërkuar me ligj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.322/2019 më datën 07.10.2019

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*

Kryesuese e Panelit

Gyltene Sylejmani

